

V E N D I M
Nr. 36, datë 26.3.1999

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga :

Hilmi Dakli,	Anëtar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci,	Anëtar i	“““
Alfred Karamuço,	Anëtar i	“““
Bardha Selenica,	Anëtare e	“““
Kristofor Peçi,	Anëtar i	“““
Sokol Sadushi,	Anëtar i	“““
Kujtim Puto,	Anëtar i	“““

Me sekretare Arbenka Lalica, më datë 11.2.1999, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.12 Akti që i përket :

KËRKUESE: DEZDEMONA SELBA, e përfaqësuar nga avokat Banush Selba.

SUBJEKTE TE INTERESUARA: FIQIRI E VELIKO KUÇI, BASHKIME KORÇA, YLFETE KASTRATI E LEFTERI BRAHUSHA, të përfaqësuar nga avokat Loli Kuçi.

O B J E K T I :

Shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve civile nr.4605, datë 14.7.1995 e datë 26.8.1994 të Gjykatës së Rrethit Tiranë; nr.519, datë 24.1.1996 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Baza ligjore: neni 38 i ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 për “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi dëgjoi përfaqësuesit e palës kërkuese të subjektit të interesuar dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N :

Kërkuesja Dezdemona Selba ka kërkuar shpalljen antikushtetues të vendimeve civile datë 26.8.1994 dhe nr.4605, datë 14.7.1995 të Gjykatës së Rrethit Tiranë; nr.519, datë 24.1.1996 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Gjatë kohës që kjo çështje shqyrtohej në Gjykatën Kushtetuese, hyri në fuqi Ligji nr.8432, datë 14.12.1998 “Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile”. Sipas nenit 473 të ndryshuar në këtë ligj, palët e mosmarrëveshjeve civile kanë të drejtë të bëjnë rekurs

në Kolegjet e Bashkuara ndaj vendimeve të formës së prerë, vendimeve të mospranimit të rekursit, si dhe vendimeve të kolegjeve të Gjykatës së Lartë. Me këtë normë krijohet një situatë e re juridike edhe për çështjet që janë në gjykim në Gjykatën Kushtetuese siç është edhe çështja në fjalë, sepse së pari ligji duke qenë procedural ka fuqi prapavepruese për marrëdhëniet procedurale të lindura para hyrjes së tij në fuqi, pra palët kanë të drejtë t’i drejtohen me rekurs Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe së dyti, Gjykata Kushtetuese është e detyruar të respektojë nenin 131 shkronja “f” të Kushtetutës, sipas të cilit ajo zhvillon gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, por vetëm pasi të jenë konsumuar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Në këto kushte, duke u miratuar me ligj një mjet tjetër juridik siç është rekursi në Kolegjet e Bashkuara, Gjykata Kushtetuese duhet ta nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit.

Nga ana tjetër nëse Gjykata Kushtetuese do të vendosë para se të jetë ushtruar e shqyrtuar rekursi në Gjykatën e Lartë do të cenonte të drejtat e individit së pari, për të ushtruar paraprakisht një mjet tjetër, juridik siç është rekursi, në Kolegjet e Bashkuara dhe së dyti, do të shqyrtohej kjo ankesë jo më për të gjitha shkaqet e parashikuara në pikat “a”, “b”, “c”, etj., të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, siç vepron Gjykata e Lartë, por vetëm për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor që ka në kompetencë Gjykata Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131 të Kushtetutës dhe 41 të ligjit nr.8373, datë 15.7.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I :

Rrëzimin e kërkesës për mungesë juridiksioni.

Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 26.3.1999

Nr. 12 i regjistrit themeltar

Nr. 36 i vendimit